

Tirane, date 22/11/2023

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE  
"BALBI 5" sh.p.k.**

**THEMELIMI**

**Neni 1**

**Ortakët themelues**

Sot me date 22.11.2023, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortakët :

1. Z. Edvin DEDA, i dtl. 05.05.1989, lindur në Durrës dhe banues në Shijak, Rruga: "Isuf Gjashta", Nd. 18, H. 1, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar; mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. I90505012L
2. Z. Enver TOTA, i dtl. 05.03.1990, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, Rruga: "Budi", Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar; mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. J00305081P
3. Z. Oligër MENGA, i dtl. 21.12.1987, lindur në Tiranë dhe banues në Kurbin, Lac, lagjia nr 5, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar; mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. BC4111079

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur "BALBI 5" sh.p.k. . Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

**EMERTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2**

**Emërtimi dhe selia**

2.1 Emërtimi i shoqërisë është BALBI 5 SHPK.

2.2 Selia e shoqërisë tregtare private "BALBI 5" sh.p.k. do të ketë selinë e saj, në rrugën "GJENERAL NIKOLS", Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.

**Neni 3**

**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

3.1 Ofrim shërbimi si Hoteleri, akomodim me qëllim pushimi apo biznesi nga shtetas shqiptare apo të huaj.

3.2 Aktivitet në fushën e Bar - Restorant - Piceri, tregtim me shumicë e pakicë i produkteve ushqimore, bujqësore blegtorale, pije freskuese, alkoolike etj.

3.3 Promovim i paketave turistike dhe shërbimeve me anë të panaiereve brenda dhe jashtë vendit, katalogëve, fletëpalosjeve, reklamave në TV etj., dhe shitja e këtyre paketave nëpërmjet agjencive të udhëtimit vendase dhe të huaja dhe shitjes së drejtpërdrejtë të klienti.

3.4 Shërbim biletarie, ndërmjetësim dhe shërbim i dhënies së makinave me qira nëpërmjet, por jo vetëm, ofrimit të paketave turistike Fly & Drive.

3.5 Nënshkrim kontratash të drejtpërdrejta me furnizuesit e shërbimeve turistike.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë Se Përgjithshme.

#### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja e veprimtarisë**

4.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").

4.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.

#### **Neni 5**

##### **Forma ligjore**

5.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

5.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me Legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 6**

##### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera Ligjorë.

#### **Neni 7**

##### **Emblema dhe Vula**

7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

## STATUTI I SHOQERISE

### KAPITALI

#### **Neni 8**

#### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private "BALBI 5" sh.p.k., do të jete 3.000.000 (tre milion leke).

1. Ortaku themelues EDVIN DEDA: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 (nje milion leke) që përben 33.4% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues ENVER TOTA: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 (nje milion leke) që përben 33.3% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Ortaku themelues OLIGER MENGA: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 (nje milion leke) që përben 33.3% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 9**

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

9.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë Se Përgjithshme.

9.2 Zmadhimi i kapitalit mund të behet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes se pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë se Përgjithshme.

9.3 Zvogëlimi i kapitalit behet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

9.4 Propozimi i zvogëlimit do ti paraqitet ekspertit kontabël te autorizuar dhe administratorit të paktën 5 dite përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblesë se Përgjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

9.5 Raporti i zvogëlimit te kapitalit do të miratohet me vendim te Asamblesë se Përgjithshme.

## **Neni 10**

### **Transferimi i kapitalit**

10.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen në përputhje me dispozita te Ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet përkatëse.

10.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueseje ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

10.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueseje me rrugë trashëgimie.

10.4 Vendosja e çfarëdo lloj barre mbi kuotat në favor të palëve te treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme.

## **ORGANET E SHOQERISE**

### **Neni 11**

#### **Vendimet e Asamblesë se Përgjithshme**

11.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Përgjithshme.

11.2 Vendimet e Asamblesë se Përgjithshme përfshijnë kryesisht:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
- Emërimin ose shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
- Miratimin e bilancit te shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
- Çdo çështje tjetër të parashikuar në ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008" Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në këtë dokument.

### **Neni 12**

## Administrimi

12.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

12.2 Administratori ka të drejta të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtoje punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme.

12.3 Administratori i shoqërisë është: Z. Enver TOTA, i dtl. 05.03.1990, lindur në Kukës dhe banor në Tiranë, Rruga: "Budi", Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar; mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. J00305081P.

12.4 Administratori është përgjegjës për veprimtarinë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- Të thërras Asamblesën e Përgjithshme;
- Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim; Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- Përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
- Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektivit të saj;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, institucione apo entitete publike ose private;
- Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit;
- Të vendosë për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryejë, në emër të shoqërisë çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- Të ndërmarre veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.

12.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pese) vjet me të drejtë ripërtëritje automatike ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## Neni 13

### Te drejtat dhe detyrimet e ortakëve

13.1 Të gjithë vendimet e ortakëve do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve. Vendimet e pa regjistruara në regjister do të konsiderohen nul dhe të pa vlefshme.

13.2 Cdo kuote i jep të drejtën, në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve (Asambleja e Përgjithshme), ortakut që e zotëron të një numri votash të barabartë me pjesëmarrjen/përqindjen e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë si dhe të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, kur deklarohet nga ortakët e shoqërisë.

13.3 Ortakët do të kenë fuqi të plote aksesimi në çdo informacion dhe të dhëna që ka lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, përfshirë të drejtën për të kontrolluar dhe menaxhuar levizjet financiare/bankare të Shoqërisë.

## **Neni 14**

### **Viti financiar**

13.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar me 31 Dhjetor te çdo viti.

13.2 Si përjashtim, viti i pare financiar i shoqërisë do te filloje nga dita e regjistrimit të shoqërisë ne Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon me 31 Dhjetor te po atij viti.

## **Neni 15**

### **Bilanci. Kontabiliteti.**

14.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe duhet te përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund te muajit mars të vitit pasardhës.

14.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhen dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave te legjislacionit përkatës. Për operacione te veçanta, shoqëria mund te beje veprime edhe me llogari të veçanta ne monedhe te huaj.

14.3 Shoqëria mund te pranoje fonde nga institucionet financiare qe operojnë ne Shqipëri ose jashtë. Për këtë qellim shoqëria mund te lere peng pjese te kapitalit si garanci ose mund te hipotekoje pasuritë e saj, vetëm me vendim te Asamblesë Se Përgjithshme.

## **Neni 16**

### **Te Ardhurat. Dividendi**

15.1 Shoqëria do te krijoje fonde rezervë për realizimin e qëllimeve te biznesit te saj ne përputhje me kërkesat e ligjit 1Nr. 9901. date 14.4.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

15.2 Të ardhurat qe rezultojnë në fund të mbylljes se çdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund te ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët qe ata zotërojnë në kapitalin shoqërisë.

15.3 Humbjet e shoqërisë do te mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakët do te përgjigjen deri ne kufirin e kontributit te tyre në kapitalin themeltar te shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të pare deri në tre ushtrimoret vijues.

## **Neni 17**

### **Likuidimi**

16.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblesë se Përgjithshme.

16.2 Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh qe do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

16.3 Likuidatori do te përgatisë raportin e likuidimit mbi gjendjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën qe nevojitet për përfundimin e tij. Ne përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Përgjithshme do të shqyrtoje bilancin përfundimtar dhe do te miratojë përfundimin e procedurave te likuidimit.

## **Neni 18**

Mosmarrëveshjet

17.1 Mosmarrëveshjet qe mund te lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, ne rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do ti nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare

**Neni 19**

Klauzole mbyllëse

Akti i themelimit, u përpilua ne 4 kopje me fuqi të njëjtë ligjorë, për t'ju shpërndare organeve kompetente dhe një kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqërisë "BALBI 5" sh.p.k.

Akti i themelimit u nënshkrua rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Tirane, date 22/11/2023

BALBI 5 SHPK

Ortakët e shoqërisë:

Z. EDVIN DEDA



Z. OLIGER MENGA



Z. ENVER TOTA

